

# KOSOVA

## RAPORTI I VITIT 2019 PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

### Përmbledhje ekzekutive

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një parlament të zgjedhur njëdhomësh (Kuvendin), i cili më pas e zgjedh një kryetar. Kuvendi duhet ta miratojë kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari. Kryeministri dha dorëheqje më 19 korrik 2019 dhe, më 22 gusht, Kuvendi votoi për shpërbërje. Siç u dekretuan nga Presidenti Hashim Thaçi, i cili u zgjodh nga Kuvendi si President në vitin 2016 për një mandat pesë-vjeçar, zgjedhjet parlamentare u mbajtën më 6 tetor. Qeveria në largim vazhdon ta kryejë rolin e kujdestarit deri në formimin e qeverisë së re, e cila nuk u formua deri në fund të vitit. Zgjedhjet Parlamentare u konsideruan të lira e të drejta.

Forcat e sigurisë përfshinin Policinë e Kosovës (PK) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilat i raportojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, respektivisht Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë vitit, qeveria filloi procesin e transformimit gradual të FSK-së në një forcë mbrojtëse territoriale, sipas një plani 10-vjeçar. Policia Kufitare, një nëngrup i PK-së, është përgjegjëse për sigurinë në kufi. Policia ruan sigurinë e brendshme me ndihmën e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, në vend, si reagues i dytë për incidente trazirash, dhe Forca e Kosovës (KFOR) e udhëhequr nga NATO-ja, një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare, si reaguese e tretë. KFOR-i është përgjegjës për sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt dhe për sigurimin e lirisë së lëvizjes në vend. Që nga gushti, misioni kishte 3.526 ushtarë nga 28 vende. Autoritetet civile mbajtën kontroll efikas të forcave të sigurisë.

Në çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshiheshin: kufizimet e panevojshme për shtypin, përfshirë dhunën ose kërcënimet e dhunës ndaj gazetarëve; korrupsionin dhe mosndëshkimin në qeveri; dhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose të komuniteteve të tjera të marginalizuara, edhe nga PK-ja.

Shumë veta në qeveri, opozita, shoqëria civile dhe mediat raportuan raste të zyrtarëve të lartë që merreshin me korrupsion dhe vepronin pa u ndëshkuar. Qeveria dhe sektori i drejtësisë ndonjëherë ndërmorën masa për t'i ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kishin kryer abuzime, vepra penale dhe krime në të kaluarën, por shumë prej tyre vazhduan të zinin poste në sektorin publik. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ndërmori hapa për t'i hetuar abuzimet dhe ndjekur penalisht personat përgjegjës. Forcat e sigurisë gjithashtu kanë marrë pjesë në trajnime për ta rritur respektimin e të drejtave të njeriut.

### **Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:**

#### **A. Privimi arbitrar i jetës dhe vrasjet e paligjshme apo të motivuara politike**

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme.

## KOSOVA

Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), i mandatuar deri në vitin 2020 për të monitoruar raste të caktuara penale e civile dhe gjykime në sistemin gjyqësor, e këshillon Shërbimin Korrektues të Kosovës, ofron mbështetje logjistike për Dhomat e Specializuara në Hagë, mban përgjegjësi të kufizuar ekzekutive në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe vazhdon të shërbejë si reagues i dytë i sigurisë për PK-në.

Që nga shtatori, 71 raste të krimeve të luftës ishin nën hetim zyrtar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK).

Në nëntor, Gjykata Kushtetuese kundërshtoi unanimitisht një ankesë përfundimtare në rastin e krimeve të luftës “Drenica II”, duke mbështetur të pesë dënimet. Dy rastet e “Drenicës” përfshinë 15 ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të dyshuar për krime lufte kundër civilëve, përfshirë torturën, keqtrajtimin e të burgosurve dhe vrasjen, të gjitha gjoja të kryera në një qendër paraburgimi të UÇK-së në fshatin Likoc në rajonin e Drenicës në vitin 1998. Rastet fillimisht rezultuan në 11 dënime në vitin 2015. Gjashtë prej të dënuarve iu shmangën vuajtjes së dënimit me burg deri në korrik të vitit 2019, kur gjykata i ktheu në burg. Që nga nëntori, rasti “Drenica I”, që u dërgua për rigjykim në vitin 2017, ishte caktuar për një seancë fillestare në Gjykatën Themelore në Mitrovicë për 26 dhjetor.

Prokuroria e Specializuar e Kosovës (PSK), me seli në Hagë, vazhdoi t’i hetonte krimet e kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Gjatë vitit pati një rritje të numrit të personave të thirrur në PSK-ja për intervista, përfshirë kryeministrin Ramush Haradinaj, i cili dha dorëheqjen nga posti (por vazhdoi të shërbente në një rol kujdestar, derisa të formohej një qeveri e re pas zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit). PSK-ja dhe paraardhësi i saj, Task Forca Speciale Hetuese e BE-së, u krijuan pas lëshimit të raportit të Këshillit të Evropës në vitin 2011, “Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”, që pretendonte për krime nga udhëheqësit individualë të UÇK-së. Një marrëveshje e vitit 2016, që ofronte bazë ligjore që Dhomat e Specializuara të Kosovës t’i zhvillonin procedurat në Holandë, hyri në fuqi në vitin 2017. Që nga dhjetori, PSK-ja nuk kishte ngritur asnjë aktakuzë.

### **B. Zhdukja**

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve qeveritare.

Që nga nëntori, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur (KQPZH) kishte të regjistruar 1.643 persona të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë konfliktit të vitit 1998-99 dhe dhuna politike që pasoi. Sipas ligjit, databaza qeveritare për persona të zhdukur nuk përfshin prejardhjen etnike të të zhdukurve, përveç nëse vullnetarisht raportohet nga familja e të zhdukurve. KQPZH-JA sugjeroi që rreth 70 për qind ishin shqiptarë dhe 30 për qind ishin serbë, romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë, goranë ose malazezë dhe të tjerë.

## KOSOVA

Në shtator, KQPZH-ja zgjodhi shtatë raste të personave të zhdukur që kishin të bënin me komunitetet pakicë me identifikimin pozitiv dhe riatdheshimin e mbetjeve të shtatë individëve, në bashkëpunim me Komisionin për Persona të Zhdukur të Serbisë dhe Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK).

### **C. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese**

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë praktika të tilla, por ligjet nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe ka pasur pretendime të vazhdueshme që të arrestuarit torturoheshin dhe keqtrajtoheshin nga policia dhe, në një shkallë më të vogël, nga personeli i shërbimit korrektues.

Që nga nëntori, Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës (IAP) raportoi se kishte pranuar 136 ankesa të regjistruara nën bazën ligjore të “ndalimit të torturës dhe të drejtave të të abuzuarve” kundër policisë dhe shërbimit korrektues, prej të cilave 63 mbetën të hapura për hetime. Kjo kategori e ankesave përfshin të gjitha pretendimet e keqtrajtimit fizik të të burgosurve, dhe IAP-i raportoi që asnjë prej tyre nuk kishte të bënte me akte të torturës.

Në janar raportuesi i posaçëm i OKB-së për tortura dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (RSKBT) publikoi një raport, bazuar në një vizitë të tij dhe të ekipit të tij të vitit 2017, që vuri në pah “me shqetësim të madh” se ai kishte marrë “pretendime të shumta dhe të vazhdueshme për tortura dhe keqtrajtim (të të arrestuarve) në duart e policisë, veçanërisht si mjet për t’i detyruar individët që ta pranonin fajësinë gjatë marrjes në pyetje në polici. Të arrestuarit raportuan se abuzimi i tillë përbëhej kryesisht nga rrahje të ashpra me grushte e shkelma, goditje me gjësende dhe kërcënime verbale e psikologjike. “Raporti i RSKBT-së tërhoqi gjithashtu vëmendjen për mungesë të mbikëqyrjes në fazën e hetimit dhe të marrjes në pyetje gjatë ndalimit, duke rezultuar në incidente të supozuara të keqtrajtimit, abuzimit dhe torturës gjatë marrjes në pyetje si mjet për t’i detyruar që ta pranonin fajësinë.

IAP-i kundërshtoi gjetjet kontestuese të RSKBT-së për pretendime të besueshme për torturë, duke raportuar që nuk kishte pranuar asnjë ankesë për torturë atë vit dhe duke shtuar që të arrestuarit kishin kanale të shumta, të sigurta për t’i paraqitur ankesat. IAP-i ka një njësi, Mekanizmin Kombëtar Parandalues kundër Torturës (MKPT), që përbëhet nga shtatë punonjës, përfshirë një mjek, një psikiatër, një punonjës social dhe dy avokatë që gjatë tërë kohës përqendrohen në parandalimin e torturës. Në vitin 2018, MKPT-ja iu nënshtrua një programi trajnues intensiv njëvjeçar, i financuar nga Këshilli i Evropës, për ta përmirësuar kapacitetin e vet. Gjatë vitit 2018 MKPT-ja gjoja kishte bërë 60 inspektime në terren të burgjeve, qendrave të ndalimit, objekteve psikiatrike dhe stacioneve policore, një rritje pothuaj 400 për qind nga viti paraprak. Ata raportuan se kishin pasur qasje të papenguar në të gjitha vendet e privimit të lirisë. MKPT-ja paraqiti raporte për gjetjet e saj, gjeneroi hetime dhe publikoi raporte përcjellëse për pajtueshmërinë e qeverisë. Të burgosurit dhe të ndaluarit mund të kontaktojnë me MKPT-në përmes avokatëve, anëtarëve të familjes, organizatave

## KOSOVA

ndërkombëtare, thirrjeve të drejtpërdrejta telefonike, ose përmes kutive postare në qendrat e ndalimit, në të cilat vetëm stafi i IAP-it ka qasje. MKPT-ja raportoi se nuk kishte raporte të besueshme për tortura gjatë vitit.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), OJQ-ja kryesore e vendit për çështje të lidhura me torturat, tha gjithashtu se nuk kishte pranuar asnjë raport të besueshëm për tortura gjatë vitit; megjithëse pohon që keqtrajtimi i të burgosurve vazhdon të mbetet problem.

Në janar, QKRVT-ja raportoi për gjoja abuzim fizik të një të burgosuri gjatë arrestimit nga dy policë në burgun e sigurisë së lartë në Dyz, afër qytetit të Podujevës. Megjithatë, inspektorati policor nuk gjeti elemente të veprës penale në sjelljen e policëve gjatë arrestimit, dhe rasti iu procedua Drejtorisë për Hetime të Brendshme të Policisë së Kosovës për hetime të mëtejshme procedurale.

Në raportin e vet të monitorimit për vitin 2018, Të Drejtat e Njeriut në Qendrat e Paraburgimit në Kosovë, të lëshuar në mars, QKRVT-ja raportoi për disa raste të keqtrajtimit të personave të ndaluar në Shërbimin Korrektues të Kosovës gjatë vitit. Në një rast, një i paraburgosur që priste seancën gjyqësore në qershor të vitit 2018 në Ferizaj u mbyll në një sallë pritjeje dhe u rrah nga dy zyrtarë korrektues. QKRVT-ja theksoi se, “Edhe pse ai ishte i përgjakur dhe nuk ndihej mirë, psikiatri vlerësoi se i arrestuari mund ta vazhdonte seancën gjyqësore dhe e njëjta ishte urdhëruar nga gjykatësi i rastit”. Thuhej që IAP-i ishte njoftuar për këtë incident.

Inspektorati Policor, një organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, njoftoi për pezullimin dhe ngritjen e kallëzimeve penale kundër gjashtë policëve të PK-së në Gjakovë, tre nga radhët e larta, pas një raporti të Avokatit të Popullit, ku përshkruhej në detaje përdorimi i tepërt i forcës ndaj një të ndaluarit. Avokati i Popullit pranoi gjithsej nëntë ankesa për keqtrajtim fizik të të ndaluarve nga policët e PK-së.

### **Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit**

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit i plotësonin disa standarde ndërkombëtare, por pati probleme të mëdha në burgje, posaçërisht dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni, ekspozimi ndaj pikëpamjeve radikale fetare apo politike dhe kujdesi mjekësor nën standarde.

**Kushtet fizike:** Kushtet fizike mbetën nën standard në disa reparte të Burgut të Dubravës, që ishin të stërngarkuara.

Gjatë këtij viti, QKRVT-ja pranoi ankesa nga të burgosurit për ngacmim verbal, dhunë mes të burgosurve dhe, në disa raste, keqtrajtim fizik nga ana e zyrtarëve korrektues, kryesisht në Burgun e Dubravës dhe në Qendrën e Ndalimit në Lipjan.

## KOSOVA

Në shtator, QKRMT-ja raportoi që të burgosurit dhe të ndaluarit kishin vështirësi për të pasur qasje në kujdes mjekësor, për pretendime për korrupsion dhe përdorim të transferimeve midis qendrave të ndryshme të paraburgimit si masë disiplinore. Përveç kësaj, disa të burgosur i vetëlënduan për ta tërhequr vëmendjen për nevojat e tyre.

Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës rihapi një hetim për vdekjen në vitin 2016 të aktivistit të partisë Vetëvendosje (VV), Astrit Dehari, duke ia caktuar rastin Prokurorisë Speciale të Kosovës, pas dorëzimit të një raporti mjekoligjor zviceran tek autoritetet e Kosovës në tetor. Autoritetet e Kosovës e cilësuan vdekjen e tij vetëvrasje në atë kohë, ndonëse partia politike VV pohonte që keqtrajtimi i Deharit nga policia dhe shërbimi korrektues ishin faktorë kontribuues. Qeveria e Kosovës kërkoi ndihmën e Zvicrës në tetor të vitit 2018; raporti i Zvicrës vuri në pah se analiza mjekoligjore nuk mund t'i përjashtonte shkaqet e tjera të mundshme të vdekjes dhe rekomandoi hetime të mëtejme.

Për shkak të trajnimit të dobët dhe stafit të pamjaftueshëm, autoritetet nuk ushtronin gjithmonë kontroll ndaj objekteve ose të burgosurve. Rreth 30 për qind e të burgosurve hyjnë në burg me varësi nga droga. Nuk kishte programe për trajtim për drogë brenda sistemit korrektues, dhe QKRVT-ja raportoi që drogat e paligjshme rregullisht kontrabandoheshin në këto objekte.

QKRVT-ja dokumentoi vonesa dhe gabime në ofrimin e kujdesit mjekësor për të burgosur, si dhe mungesën e trajtimit të specializuar. Në shumë raste, këto kushte i detyruan të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme përmes burimeve private. QKRVT-ja vërejti të meta në sistemin e kujdesit shëndetësor në Burgun e Dubravës dhe raportoi për numër të pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor.

Objektet dhe trajtimi për të burgosur me aftësi të kufizuara mbetën nën standarde. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës ofronte trajtim dhe strehim të kufizuar për të paraburgosur me aftësi të kufizuara mendore. Avokatët e personave me aftësi të kufizuara e fajësonin qeverinë që rregullisht i vendoste të paraburgosurit me aftësi të kufizuara mendore bashkë me të paraburgosurit e tjerë. Të paraburgosurit mbaheshin ndaras nga të burgosurit e dënuar. Ligji kërkon që kriminelët e dënuar, me probleme të dokumentuara të shëndetit mendor, të mbahen në objekte të dedikuara për kujdes të shëndetit mendor, por këta të burgosur shpesh vendoseshin në burgje standarde për shkak të mbingarkesës në institucionet e shëndetit mendor. Përveç farmakoterapisë dhe konsultimeve të rregullta me psikiatër, të burgosurve me probleme të shëndetit mendor nuk u sigurohet ndonjë veprimtari profesionale apo terapeutike.

Kushtet në burgje për luftëtarët e huaj terroristë dhe të dënuarit për vepra terroriste nuk dallonin shumë nga kushtet e të burgosurve në burgjet e përgjithshme

**Administrata:** Autoritetet nuk zhvillonin gjithmonë hetime të duhura për keqtrajttime. QKRVT-ja vuri në pah se mekanizmi i brendshëm për ankesa, i paraparë me ligj, nuk funksiononte, pasi të burgosurit shpesh nuk i lajmëronin abuzimet për shkak të mungesës së

## KOSOVA

konfidencialitetit dhe frikës nga hakmarrja. QKRVT-ja gjithashtu vuri në pah se autoritetet nuk ofronin vendime me shkrim me të cilat arsyetohej izolimi në vetmi.

**Monitorimi i pavarur:** Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur për të drejta të njeriut, por vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit kishte qasje të vazhdueshme e të papenguar në objektet korrektuese gjatë vitit. QKRVT-ja dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut duhej të njoftonin 24 orë më parë për vizita të planifikuara. QKRMT-ja vuri në pah se Shërbimi Korrektues ka lëshuar dhe harmonizuar forma të masave disiplinore për t'i përshkruar masat specifike, kohëzgjatjen, arsyetimin dhe këshillat ligjore për ankesat e të burgosurve.

**Përmirësimet:** Përmirësimet e bëra gjatë vitit përfshinin punësimin e 120 zyrtarëve të rinj korrektues, hapjen e pjeshme të Qendrës së re të Paraburgimit në Prishtinë, funksionimin e një pilot programi të njesisë për vlerësim dhe klasifikim, dhe një procedurë për t'u lejuar disa të burgosurve që të komunikonin me familje përmes Skype-it.

### D. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikojnë të drejtën e çdo personi për ta kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij/saj në gjykatë, dhe Qeveria, EULEX-i dhe KFOR-i në përgjithësi i respektuan këto ndalesa.

Personeli i EULEX-it dhe i KFOR-it nuk i nënshtrohej sistemit ligjor të vendit, por masave disiplinore të misionit dhe të vendeve të tyre përkatëse.

Qeveria nganjëherë hetonte abuzimin dhe korrupsionin, ndonëse mekanizmat për ta bërë një gjë të tillë nuk ishin gjithmonë efikas ose i nënshtroheshin ndërhyrjes politike. Forcat e sigurisë nuk siguronin pajtim me urdhra të gjykatave kur zyrtarët vendës dështonin t'i zbatonin ato. Shumë policë janë arrestuar nën akuzat për korrupsion gjatë vitit dhe pandëshkueshmëria ishte problem.

IPK-ja ishte përgjegjës për shqyrtimin e ankesave për sjellje të policëve. Që nga gushti, ai kishte shqyrtuar 834 ankesa të qytetarëve për sjellje të policëve dhe 240 policë ishin nën hetime. IPK-ja i cilësoi 544 ankesa si shkelje disiplinore dhe ia procedoi ato Njesisë së PK-së për Standarde Profesionale; IPK-ja i cilësoi 290 ankesa të tjera si raste penale. Shumë hetime të nisura nga IPK-ja në vitin 2018 mbetën pezull në fund të vitit. IPK-ja vazhdoi hetimin e vet për keqtrajtim të pretenduar të zyrtarit të lartë të qeverisë serbe, Marko Gjuriq, nga PK-ja gjatë arrestimit dhe deportimit të tij për hyrje të paligjshme në mars të vitit 2018. Që nga gushti, IPK-ja nuk kishte ardhur në ndonjë përfundim për këtë rast.

Gjatë vitit, 25 policë u dënuan për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe ryshfet; secili mori dënim 60-ditor. Katër nga policët ishin nën arrest shtëpiak dhe tre mbetën të lirë. Gjatë të njëjtës periudhë, IPK-ja paraqiti 13 kallëzime penale dhe shtatë raporte të posaçme pranë

## KOSOVA

zyrave përgjegjëse të Prokurorisë së Kosovës. Dënimet për ryshfet silleshin prej 6 deri në 31 muaj burgim dhe gjobat prej 1.000 deri në 3.000 euro (1.100 në 3.300 dollarë) për person.

### **Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve**

Sipas ligjit, përveç kur krimi është në zhvillim e sipër, policia mund të arrestojë të dyshuar vetëm me urdhra të bazuar në prova dhe të lëshuar nga një gjykatës ose prokuror. Brenda gjashtë orëve, prokurorët duhet t'ia lëshojnë personit të arrestuar një deklaratë me shkrim ku përshkruhen vepra e dyshuar dhe baza ligjore për akuzim. Autoritetet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjykatësit brenda 48 orëve dhe duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje në avokatin të cilin e zgjedhin apo në avokatin e siguruar nga shteti. Ekziston edhe sistemi i dorëzansisë, por rrallë përdorej nga gjykatat. Ato shpesh i lironin të ndaluarit pa dorëzani në pritje të gjykimit.

Të dyshuarit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në të gjitha fazat e hetimit, përveç pyetjeve për identitetin e tyre. Të dyshuarit kanë të drejtë për ndihmë falas të avokatit dhe të përkthyesit, dhe për trajtim mjekësor e psikiatrik. Në të gjitha fazat e hetimit, të dyshuarit mund të komunikojnë me përfaqësuesin e tyre ligjor dhe ta njoftojnë një anëtarë të familjes për arrestimin e tyre.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga data e arrestimit, dhe mund ta vazhdojë paraburgimin deri në një vit. Pas ngritjes së aktakuzës e deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta caktojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzansisë si alternativa ndaj paraburgimit.

Ndonëse në disa raste policët ishin sekretë, ata në përgjithësi i kryenin arrestimet duke përdorur urdhërarreste. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh, dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Ndonëse zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për vendosje të shpejtë të rasteve, QKRVT-ja raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët përkohësisht nuk ishin në dispozicion.

OJQ-të raportuan se autoritetet nuk i lejonin gjithmonë personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit dhe në disa raste u lejonin konsultime me avokat vetëm pasi hetuesit policorë kishin filluar marrjen formale në pyetje. Në disa raste, të ndaluarve iu lejua qasja në avokat vetëm pas marrjes formale në pyetje. Disa të ndaluar ankoheshin që, përkundër kërkesës për avokat, kontakti i tyre i parë me avokat ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë.

Ligji ia kufizon policisë përdorimin e forcës vetëm për ta "mbrojtur jetën e një personi, për ta parandaluar një sulm, për ta parandaluar një vepër penale, për ta parandaluar arratisjen e

## KOSOVA

kryesit ose, kur masat e tjera nuk janë të suksesshme, për ta arritur një synim tjetër të ligjshëm policor”. Ligji gjithashtu parashikon që kur përdoret forca, policia “do të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e një personi dhe ta minimizojë çdo pasojë të dëmshme”.

Në maj, një operacion i PK-së kundër kontrabandimit në veri të Kosovës rezultoi në 11 ankesa për përdorim të tepërt të forcës, të gjitha këto u përqendruan në dëmtim të pronës. Ankesat kishin të bënin kryesisht me largimin, nga PK-ja, të pengesave të vendosura në rrugëkalim (d.m.th. automjete që i largonin kamionët e mëdhenj nga rruga). Një hetim i IPK-së ishte duke vazhduar në fund të vitit.

**Paraburgimi:** Ndalimet e gjata, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem, mesatarisht gjashtë muaj. Ligji u lejon gjykatësve ta ndalojnë të pandehurin në pritje të gjyqimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka të ngjarë t’i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat, të ndikojë në dëshmitarë, të ikën, ta përsërisë veprën penale, të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar justifikim të mbështetur në prova. Ndalimi i gjatë ndodhte gjithashtu për shkak të joefikasitetit dhe korrupsionit në gjyqësor.

### **E. Mohimi i gjyqimit të drejtë publik**

Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Sipas Komisionit Evropian, OJQ-ve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadalshëm dhe i mungonin mjetet për të siguruar llogaridhënie nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat gjyqësore i nënshtroheshin ndërhyrjes politike, me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta.

Ndonëse numri i lëndëve të grumbulluara dikur paraqiste pengesë të madhe, gjykatat po bëhen gjithnjë e më efikase në zgjidhjen e tyre në sajë të ndihmës ndërkombëtare, e cila prezantoi praktika aktive të menaxhimit të lëndëve, si dhe mbështetje të nivelit të politikave për menaxhim të përmirësuar të lëndëve. Që nga gushti, gjykatat e kanë ulur për 78 për qind numrin statik të lëndëve të grumbulluara të Gjykatave Themelore, duke zgjidhur gjithsej 30.897 lëndë që nga viti 2016. Shkalla e zgjidhjes së lëndëve penale gjatë periudhës prill-qershor u rrit dukshëm, duke u ngritur në 186 për qind krahasuar me 122 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), deri në korrik rreth 100.000 lëndë civile e penale administrative e komerciale pritnin gjykimin, një ulje prej afro 65 për qind në krahasim me vitin 2018.

Gjatë vitit, Ministria e Drejtësisë sponsorizoi ndryshime në një ligj të vitit 2010 mbi përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve, që synonte arritjen e paanshmërisë në gjyqësorin e Kosovës. Përveç kësaj, regjistrat për regjistrimin e ankesave kundër gjykatësve në nivel të gjykatës dhe të KGJK-së kishin përfunduar dhe u ishin dorëzuar të gjitha gjykatave në gusht dhe tani janë në shqyrtim. Në pajtim me rregulloren disiplinore,

## KOSOVA

KGJK-ja përzgjedhi 70 gjykatës, të cilët u rekomanduan nga kryetarët e gjykatave, për të shërbyer në panelet përgjegjëse për hetimin e ankesave disiplinore. Mandati i tyre është të sigurojnë vazhdimësi: 25 gjykatës u zgjodhën për të shërbyer në një mandat një vjeçar, 23 për mandat dyvjeçar, dhe 22 për mandat trevjeçar. Anëtarët e rinj do të zgjidhen çdo vit për të siguruar plotësim të numrit prej 70 gjykatësve. Që nga hyrja në fuqi e procesit të ri disiplinor, kryetarët e gjykatave, si autoritet kompetent, kanë marrë 75 ankesa kundër gjykatësve. Prej tyre, autoriteti kompetent refuzoi 24 ankesa, vazhdoi t'i shqyrtonte 49 të tjera, ndërsa dy kërkesa për hetim janë dorëzuar në KGJK. KGJK-ja formoi një panel hetues dhe ishte në proces të formimit të një paneli të dytë në fund të vitit.

Autoritetet nganjëherë nuk i respektuan urdhrat e gjykatave, përfshirë urdhrat e Gjykatës Kushtetuese, posaçërisht kur aktvendimet ishin në favor të pakicave, si në shumë raste të serbëve për rikthim të pronës. Autoritetet lokale në Deçan vazhduan ta refuzojnë zbatimin e vendimit të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese që konfirmonte pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe për më tepër se 24 hektarë tokë afër Manastirit të Deçanit. Asnjëri prej zyrtarëve të përfshirë në moszbatimin e urdhrat të gjykatës nuk është sanksionuar.

### **Procedurat e gjykimit**

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm. Edhe pse pati të meta të mëdha në sistemin e drejtësisë, përfshirë rastet e ndërhyrjes politike, ligji në përgjithësi u respektua. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre, për gjykim të drejtë, me kohë e publik ku gjykatës mund t'i drejtohen në gjuhën e vet amtare, të jenë të pranishëm në gjykimet e veta, të heshtin dhe të mos detyrohen të dëshmojnë apo pranojnë fajësinë, të përballen me dëshmitarë, t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim. Vendi nuk mban gjykime me juri.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) është e mandatuar nga qeveria për të ofruar ndihmë juridike falas për individët me të ardhura të ulëta. Gjatë vitit, ANJF-ja ndërmori fushata në terren duke synuar komunitetet e cenuara e të marginalizuara dhe përhapit informacione për ndihmë juridike përmes platformave online. Në maj, OKB-ja e financoi OJQ-në Qendra për Ndhimë Juridike për të garantuar ndihmë juridike falas për gratë në rastet si verifikimi i pronësisë së pronës, pretendimet e dhunës seksuale dhe pretendimet për të drejtat për pensione nga Serbia.

### **Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë**

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

### **Procedurat dhe mjetet juridike civile**

## KOSOVA

Ka mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e të drejtave të tyre për proces të drejtë. Kushtetuta i përfshin si të detyrueshme obligimet e rena dakord në konventa të shumta ndërkombëtare. Individët mund ta paraqesin në Gjykatën Kushtetuese shkeljen e këtyre konventave, si dhe shkeljet e procesit të drejtë sipas ligjeve vendore.

### **Rikthimi i pronës**

Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe ankesat e shumta për të njëjtën pronë, vazhduan ta pengonin zgjidhjen e rasteve të rikthimit të pronës që buronin nga lufta dhe pas saj; mbi 96 për qind të ankesave ishin parashtruar nga serbët. Qytetarët privatë dhe komunitetet fetare nuk ishin shumë të suksesshëm në paraqitjen e kërkesave për rikthim të pronës së sekuestruar apo konfiskuar gjatë kohës jugosllave.

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) ka autoritet për të vendosur për kërkesa dhe zgjidhje të dallimeve mes dokumenteve kadastrale që Serbia i largoi nga Kosova në vitin 1999 dhe të dhënave aktuale kadastrale të Kosovës. Parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të ankohen në gjykata kundër vendimeve.

AKKVP-ja kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve për dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm dhe dështoi në largimin e strukturave ilegale të ndërtuara në tokë pasi pronarëve u ishte konfirmuar e drejta e tyre. Shumica e parashtruesve të kërkesave ishin serbë. Agjencia gjithashtu luftoi për t'i kompensuar personat që humbën pronën e tyre në vitet 1990, shumica e tyre shqiptarë. Që nga gushti, AKKVP-ja kishte 74 dëbime në pritje, prej të cilave 38 do të ekzekutoheshin në rajonin e Mitrovicës, ku përfshihej kryesisht prona në pronësi të shqiptarëve. Riuzurpimi i pronës vazhdoi të mbetej problem. Organizatat e shoqërisë civile janë ankuar se vendit i mungonte një sistem efektiv për t'u mundësuar serbëve të zhvendosur nga Kosova, që jetonin jashtë vendit, për të paraqitur kërkesa pronësore dhe për të marrë njoftime lidhur me vendimet për kërkesa pronësore.

Kuvendi i Kosovës e caktoi një individ si shef të AKKVP-së, i cili nuk i plotësonte kualifikimet për punësim dhe e kaluara e të cilit përfshinte gjoja përfshirje në krime lufte dhe korrupsion. Përkundër thirrjeve të shumta ndërkombëtare për dorëheqjen e atij individi, ai mbeti në detyrë, duke e ulur besueshmërinë e institucionit.

### **F. Ndërhyrja arbitrare ose e paligjshme në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë**

## KOSOVA

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe nuk pati raportime që Qeveria, EULEX-i apo KFOR-i nuk i respektuan këto ndalesa.

### **Seksioni 2. Respektimi i lirive civile, përfshirë:**

#### **A. Lirinë e fjalës dhe të shtypit**

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e shtypit. Ndonëse Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë, pati raportime të besueshme që disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe radikale fetare përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e mediave. Mediat gjithashtu hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, siç parashihej me ligj, dhe u përpoqën të sigurojnë mjete financiare për të mbetur të pavarura. Komisioni i Pavarur për Media i rregullon frekuencat e transmetimit, u lëshon leje transmetuesve publikë e privatë dhe përcakton politika transmetuese.

**Shtypi dhe mediat, përfshirë mediat elektronike:** Mediat e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim. Megjithatë, pati raportime që zyrtarë qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur ushtruan presion ndaj pronarëve të mediave, redaktorëve individualë dhe reporterëve për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Disa gazetarë u përmbajtën nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike ose të punës.

Vështirësitë financiare të medimeve e vunë në rrezik pavarësinë redaksionale të të gjitha mediave. Përderisa disa medime financiarisht të pavarura zhvilluan politika redaksionale dhe transmetuese të pavarura nga interesat politike dhe afariste, medimet me më pak burime nganjëherë pranuan ndihmë financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve. Sipas disa redaktorëve, financimi ishte i kufizuar pjesërisht për shkak të ngurrimit të qeverisë për t'i reklamuar programet e saj në media që publikonin materiale kritike për të.

**Dhuna dhe ngacmimi:** Që nga shtatori, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe mediat raportuan për 17 raste në të cilat zyrtarë qeveritarë, grupe afariste, grupe të komunitetit apo grupe radikale fetare cenuan lirinë e shtypit duke i sulmuar fizikisht ose kërcënuar gojarisht gazetarët. Në një rast, një gazetar që raportonte për prishjen e një qendre të palicencuar tregtare u përball me dhunë nga sigurimi i qendrës tregtare dhe civilët që rrëmbyen pajisjet e tij, e goditën në fytyrë dhe parandaluan raportimin e tij për këtë ngjarje.

**Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes:** Nuk kishte raportime për censurim të drejtpërdrejtë të mediave të shkruara apo elektronike; megjithatë, gazetarët pohonin që presioni nga politikanët dhe grupet e organizuara kriminale shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre

## KOSOVA

fizike apo vendin e tyre të punës. Gazetarët nganjëherë pranonin oferta për përfitime financiare në këmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi. Sipas AGK-së, zyrtarët qeveritarë, si dhe kriminelë të dyshuar, gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamat nga gazetatat që publikonin material kritik për ta. Në gusht AGK-ja denoncoi një deklaratë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) që e denigronte të përditshme Gazeta Express si “të rreme”. AGK-ja deklaroi se ky pretendim i PDK-së është në përputhje me deklaratat e mëparshme që kritikojnë mediat dhe është ndërhyrje në media. AGK-ja raportoi se në maj, kryetari i PDK-së dhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, e thirri kryeredaktorin e Gazetës Express, Leonard Kerquki, në përpjekje për të ndikuar në politikat ditore.

Gazetarët u ankuan që pronarët dhe menaxherët e mediave nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë, partitë politike apo zyrtarë të caktuar. Në disa raste, gazetarët raportonin që pronarët i kërcënonin se do t'i largonin nga puna nëse vazhdonin të shkruanin raporte kritike. Gazetarët gjithashtu u ankuan që pronarët i ndalonin të raportonin për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

### **Liria e internetit**

Qeveria nuk e kufizoi ose ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i monitoronte bisedat private në internet pa leje përkatëse ligjore.

### **Liria akademike dhe ngjarjet kulturore**

Qeveria nuk i kufizonte ngjarjet kulturore. Sistemi arsimor u nënshtrohej emërimeve politike të drejtorëve të shkollave dhe të mësimdhënësve në të gjitha nivelet. Megjithëse qeveria prezantoi reforma, emërimi politik i mësimdhënësve rezultoi në performancë të dobët, pasi ata nuk gëzuan mbështetje të plotë as në nivelin qendror as në atë lokal. Në shtator Ministria e Arsimit prezantoi një udhëzim administrativ për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave fillore për ta depolitizuar procesin e punësimit në atë nivel.

### **B. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit**

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit paqësor dhe asociimit, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

### **C. Liria e fesë**

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi liritë fetare* të Departamentit të Shtetit në: [www.state.gov/religiousfreedomreport/](http://www.state.gov/religiousfreedomreport/).

## KOSOVA

### D. Liria e lëvizjes

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

Qeveria nuk i konsideronte dokumentet personale të lëshuara nga Serbia, që mbanin dy emra të qyteteve të Kosovës, si dokumente të vlefshme udhëtimi, duke e vështirësuar kështu lirinë e lëvizjes për shumë anëtarë të komunitetit serb të Kosovës për të udhëtuar në Kosovë dhe nga Kosova, përveç nëse i përdornin dy vendkalimet kufitare me Serbinë të vendosura në komunat me shumicë serbe në veri. Përmirësimet në regjistrin civil në vitin 2018 zgjeruan në masë të madhe qasjen e serbëve të Kosovës në dokumente të identifikimit, dhe numri i serbëve të Kosovës që u pajisën me këto dokumente u rrit shumë gjatë këtij viti.

**Lëvizjet brenda vendit:** Ura kryesore që lidh Mitrovicën veriore dhe jugore mbeti e mbyllur për qarkullim të veturave, por ishte plotësisht e hapur për këmbësorë. Urat e tjera që i lidhin këto dy qytete ishin plotësisht të hapura.

**Mërgimi:** Kthimi i refugjatëve ashkalinj, egjiptianë dhe romë, të zhvendosur nga lufta, mbeti problem. Përfaqësuesit parlamentarë të këtyre komuniteteve raportonin që paragjykimi shoqëror e pengonte kthimin e rreth 400 ashkalinjëve, egjiptianëve dhe romëve, që më parë ishin banorë të këtij vendi, dhe e informuan UNHCR-së se ata ishin të gatshëm të ktheheshin nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

### E. Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

UNHCR-ja vlerësoi se 90.000 persona të zhvendosur nga konflikti i vitit 1999 në vend ende kishin nevojë të lidhura me zhvendosjen në rajon. Prej tyre, 65.000 vlerësohej të ishin në Serbi, 16.406 në Kosovë, 729 në Mal të Zi dhe 394 në Maqedoninë e Veriut. Në përgjithësi, 2.104 familje me 8.367 persona të zhvendosur, kryesisht serbë të Kosovës, shprehën interesim për kthim të ndihmuar nga UNHCR-ja në vend. Qeveria nuk ka lëshuar asnjë informacion se sa individë janë kthyer në vend gjatë vitit.

Që nga qershori, Ministria për Komunitete dhe Kthime raportoi se 57 individë, kryesisht serbë të Kosovës, ishin kthyer në vendin e origjinës në Kosovë. Pengesat për t'u kthyer përfshinin mungesën e ndarjes së tokës për rindërtim të shtëpive, mungesën e perspektivave ekonomike dhe diskriminimin shoqëror. Sipas UNHCR-së, mungesa e një regjistrimi të detajuar dhe profilizimi adekuat i të dhënave i lanë personat e zhvendosur pa mbrojtje të drejtave të njeriut dhe plane për zhvillim.

Gjatë vitit, Ministria për Komunitete dhe Kthime lejoi ndërtimin e 108 shtëpive për të kthyerit serbë, ashkalinj, romë dhe egjiptianë. Në vitin 2018 dhe gjatë këtij viti, qeveria ndau më shumë se 3.5 milionë dollarë për ndërtimin e shtëpive për të gjitha komunitetet jo-serbe, përveç goranëve, të cilët u grupuan me marrëveshje me anëtarët serbë të Kuvendit.

## KOSOVA

Procesi i kthimit në disa zona të vendit vazhdoi të shënohej nga incidente të sigurisë ose nga ngurrimi i komuniteteve lokale për ta pranuar kthimin ose vizitat e serbëve të kthyer. Në janar, shqiptarët në Gjakovë, përfshirë personat, familjarët e të cilëve ende janë të zhdukur, protestuan kundër pelegrinazhit të serbëve të zhvendosur në kishën ortodokse serbe të qytetit.

Qeveria promovoi kthimin e sigurt dhe vullnetar të PZHBV-ve. Përmes Ministrisë për Komunitete dhe Kthime, ajo promovoi politika dhe mbrojtje për PZHBV-të në përputhje me politikat e BE-së dhe bashkëpunoi me organizatat vendore e ndërkombëtare për ta siguruar qasjen e PZHBV-ve në pronat e tyre dhe në mjete për kthimin e tyre të qëndrueshëm. Këto përfshijnë ndihmën për riposedim të pronës, ndarjen e tokës për shtëpi, dhe perspektiva të përmirësuar socio-ekonomike.

Policia e Kosovës vazhdoi praninë e saj në zonat me pakica etnike dhe të kthyer si masë për ndërtimin e besimit për të kthyerit.

### F. Mbrojtja e refugjatëve

**Deportimi:** Më 24 qershor, Kuvendi miratoi raportin përfundimtar të komitetit të tij hetimor për dëbimin, në mars të vitit 2018, të gjashtë shtetasve turq që banonin legalisht në Kosovë. Raporti i komitetit vuri në pah shkelje të rënda të ligjit, përfshirë deportimin e një burri që nuk ishte identifikuar në kërkesën për ekstradim. Kuvendi publikoi raportin e vet përkundër muajve të frikësimit dhe ndërhyrjes politike.

Ndërsa Prokuroria Speciale (PSRK) nuk e ka përfunduar hetimin e vet, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) paraqiti në gusht kallëzim penal kundër 22 policëve të përfshirë në këtë operacion për shkelje penale. Qeveria turke i kishte akuzuar qytetarët turq për lidhje të supozuara me të ashtuquajturën Organizata Terroriste Fethullah.

Në shtator, Gjykata e Apelit konfirmoi një aktvendim të Gjykatës Themelore të Prishtinës se arsyetimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për heqjen e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq të dëbuar ishte i pabazë.

**Qasja në azil:** Ligji parashikon dhënien e statusit të azilit ose refugjatit me mbrojtje plotësuese, një sistem për t'u siguruar mbrojtje refugjatëve, dhe pranim të përkohshëm të azilkërkuesve gjersa rastet e tyre gjykohen.

Objektet e pranimi në qendrën për azil mund të pranojnë fëmijë, por objektit i mungonin procedurat standarde të operimit për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar që kërkonin azil dhe për përcaktimin e të drejtës së tyre për azil. Megjithatë rastet e azilit kanë vazhduar të rriten, Kosova është kryesisht vend tranzit dhe ata që kërkojnë azil zakonisht largoheshin nga vendi dhe nuk merrnin pjesë në seancat e tyre. Numri gjithnjë e më i madh i azilkërkuesve nuk e ka

## KOSOVA

tejkalar ende kapacitetin e vendit. Ata që kërkojnë azil në vend vendosen në qendrën e azilit gjatë gjithë vitit.

**Qasja në shërbimet themelore:** UNHCR-ja raportoi se azilkërkuesit morën strehim, ushqim të rregullt dhe veshmbathje, ndërsa organizatat partnere të UNHCR-së ofruan vlerësime psikologjike, shërbime këshillimi dhe ndihmë juridike. Mungesa e shërbimeve të përkthimit për një numër gjuhësh mbeti problem në nivelin qendror dhe lokal. UNHCR-ja pohonte që kujdesi shëndetësor dhe trajtimi psikologjik ishin joadekuat.

**Mbrojtja e përkohshme:** Qeveria u siguroi mbrojtje të përkohshme, të ashtuquajtur mbrojtje shtesë, individëve që mund të mos kualifikohen si refugjatë. Gjatë qershorit, qeveria i ofroi mbrojtje shtesë një personi.

### **G. Personat pa shtetësi**

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese që mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet. Fëmijët e lindur nga prindërit që nuk janë shtetas të Kosovës e fitojnë shtetësinë për shkak të lindjes në vend; kjo më së shpeshti ndodh me anëtarët e komuniteteve pakicë, me numër të madh të banorëve, shtetësia e të cilëve nuk është dokumentuar. Procedurat e qeverisë parashikojnë qasje në natyralizim për personat që marrin statusin e personit pa shtetësi apo të refugjatit pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës.

Ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë personave pa shtetësi t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet, megjithatë, zbatimi i tyre ndryshonte nga komuna në komunë. Kapaciteti i qeverisë për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Gjatë vitit, UNHCR-ja u ndihmoi 900 personave "ligjërisht të padukshëm" (për shkak të pamundësisë së tyre për të ofruar dëshmi për vendin e tyre të lindjes) të grupeve të ndryshme etnike, shumica e të cilëve i takonin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, dhe rreth 100 personave të komunitetit shqiptar.

Banorët e paregjistruar nuk marrin përfitime të ndihmës sociale, nuk kanë të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistrojnë tituj pronësie ose t'i ruajnë të drejtat për pronë të trashëguar apo të transferuar. Fëmijëve të lindur nga prindërit e zhvendosur jashtë vendit dhe të cilët kanë hyrë me prindërit e tyre të ripranuar, shpesh u mungonte dokumentacioni, përfshirë certifikatat e lindjes, nga vendi i tyre i lindjes. Autoritetet nuk kanë zhvilluar ndonjë zgjidhje sistematike për këtë problem. UNHCR-ja financoi një fushatë për regjistrimin civil të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të vendit gjatë gjithë vitit.

### **Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në proces politik**

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2019  
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

## KOSOVA

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta zgjedhur qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve periodike të lira e të drejta, me votim të fshehtë, në bazë të votimit të përgjithshëm e të barabartë.

Qeveria serbe vazhdoi t'i drejtonte disa struktura paralele ilegale qeveritare në komunat me shumicë serbe dhe në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti goran. Besohet që këto struktura shpesh përdoren nga qeveria serbe për të ndikuar në komunitetet serbe dhe gorane dhe në përfaqësuesit politikë.

Disa anëtarë të komunitetit serb pohuan hakmarrje nga kundërshtarët politikë, duke cekur ndikimin e qeverisë serbe dhe frikësimin e kundërshtarëve të mundshëm politikë ndaj partisë kryesore politike të serbëve të Kosovës (Lista Serbe) para zgjedhjeve të 6 tetorit të vendit.

### **Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike**

**Zgjedhjet e fundit:** Vendi i mbajti zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 6 tetor, dhe diskutimet për formimin e qeverisë ishin duke vazhduar në fund të vitit. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe të pavarur e vlerësuan procesin si përgjithësisht të lirë e të drejtë. Megjithatë, fushata u përshkua me kërcënime brenda komunitetit serb të Kosovës. Disa serbë të Kosovës raportuan se ishin nën trysni për të mos mbështetur asnjë parti tjetër, përveç Listës Serbe, një parti e lidhur ngushtë me qeverinë serbe.

Zgjedhjet e fundit të përgjithshme komunale të vendit u mbajtën në vitin 2017. Pas dorëheqjes, në nëntor të vitit 2018, të kryetarëve në katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe, zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë në këto komuna u mbajtën më 19 maj. Të gjithë kandidatët serbë të Kosovës i përkisnin Listës Serbe; kryetarët e zgjedhur më parë garuan pa asnjë kundërkandidat dhe u rizgjodhën në këto zgjedhje.

**Partitë politike dhe pjesëmarrja politike:** Në pjesën më të madhe të vendit, partitë politike vepruan lirshëm dhe nuk pati pengesa të mëdha për regjistrim. Në komunat me shumicë serbe, kandidatët e opozitës dhe të pavarur raportuan për presion ndaj kandidatëve të tyre për t'u tërhequr nga zgjedhjet dhe në votues për ta mbështetur Listën Serbe. Përfaqësuesit e opozitës serbe raportuan kërcënime dhune gjatë zgjedhjeve të 19 majit për kryetarë komune nga përkrahësit e Listës Serbe dhe qeveria serbe. Përkatësia partiake shpesh luante rol në qasjen në shërbime qeveritare dhe mundësi sociale dhe për punësim.

**Pjesëmarrja e grave dhe pakicave:** Asnjë ligj nuk e kufizon pjesëmarrjen në proces politik dhe anëtarët e grupeve pakicë dhe gratë morën pjesë në to. Megjithatë, OJQ-të raportuan se pjesëmarrja e votuesve ndër gra ishte shumë më e ulët sesa ndër votuesit meshkuj. Partitë që përfaqësonin komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, goran dhe turk bënë fushatë lirshëm në gjuhën e tyre amtare.

## KOSOVA

Përfaqësimi i pakicave etnike në Kuvend ishte më shumë se proporcional me pjesën e tyre në popullsi, por partitë politike që përfaqësonin pakicat etnike i kritikuan partitë shumicë që nuk u konsultuan me to për çështje të rëndësishme. Deputetët e Listës Serbe e kanë bojkotuar pjesëmarrjen në seanca të Kuvendit që nga nëntori i vitit 2018, kur vendi vendosi tarifatat për produktet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

### **Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri**

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion ndaj zyrtarëve, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Zyrtarët nganjëherë përfshiheshin në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi. Rastet e korrupsionit shpesh i nënshtroheshin apelimit të përsëritur dhe sistemi gjyqësor shpesh lejonte parashkrimin e rasteve pa i gjykuar ato.

**Korrupsioni:** Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit (AKK) dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në qeveri. Që nga shtatori, PSRK-ja ngriti 10 aktakuza për korrupsion në rastet e referuara nga AKK-ja. Dënimet për akuza për korrupsion vazhduan të paraqisnin një përqindje të vogël të personave të hetuar dhe të akuzuar.

OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare identifikuan dështime të shumta të supozuara nga sistemi i drejtësisë në ndjekjen penale të korrupsionit, duke vënë në pah se vetëm disa raste të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultuan në aktakuza. Dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë të shpallur fajtorë për korrupsion shpesh ishte i butë. OJQ-të raportuan se aktakuzat shpesh dështuan sepse prokurorët ngrinin akuza të pasakta ose bënë gabime procedurale.

Që nga shtatori, prokurori i shtetit kishte pranuar 174 kallëzime penale ku përfshiheshin 366 persona, gjë që çoi në 81 aktakuza ku përfshiheshin 126 persona. Këto rezultuan në 52 dënime për korrupsion: 21 persona u dënuan me burg, 21 u dënuan me gjoba, dhe 10 u dënuan me kusht ose morën lloje të tjera të dënimeve.

Në dhjetor ish-ministri i Bujqësisë, Nenad Rikallo, dhe gjashtë zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Bujqësisë u akuzuan për abuzim të pushtetit për gjoja shmangie të masave mbrojtëse ligjore dhe manipulim të procesit të grantit të ministrisë për t'ua ndarë miliona dollarë kompanive që ishin në pronësi të bashkëpunëtorëve politikë.

Gjatë këtij viti, në të paktën katër raste të korrupsionit të profilit të lartë, Gjykata Supreme gjeti që gjykatat e ulëta e kishin shkelur kodin penal në dobi të të pandehurve. Prokuroria përdori mjete të jashtëzakonshme juridike dhe i kërkoi Gjykatës Supreme t'i vlerësonte vendimet e shqiptuara nga gjykatat e ulëta në këto raste. Sipas kodit të procedurës penale, Gjykata Supreme është në gjendje vetëm t'i konfirmojë shkeljet; ajo nuk mund ta ndërmarrë masa ndëshkimore kundër të pandehurve.

## KOSOVA

Një raport i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) kritikoi trajtimin e PSRK-së për një rast të vitit 2018 në të cilin prokurori dyshohet të ketë përdorur makinacione administrative për t'iu shmangur ngritjes së aktakuzave për korrupsion ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë, të cilët u mundësuan 19.060 individëve që në mënyrë të paligjshme ta fitojnë statusin e veteranit të luftës dhe të marrin përfitime financiare nga shteti. Një raport i marsit për pandëshkueshmërinë, korrupsionin dhe monitorimin e rasteve të korrupsionit prej vitit 2016-18 deri në vitin 2020 zbuloi se gjykatat ngritën 59 aktakuza kundër 68 zyrtarëve të nivelit të lartë; gjykatat i hodhën poshtë aktakuzat kundër nëntë zyrtarëve; i liruan 16; dhe pesë i hodhën poshtë. Gjykatat shqiptuan dënime kundër 11 prej 68 zyrtarëve të nivelit të lartë, tetë prej të cilëve u dënuan me kusht dhe një me gjobë. Procedurat ndaj 27 zyrtarëve të nivelit të lartë ishin në vazhdim e sipër.

Qeveria mbledhi një komision hetimor parlamentar për t'i shqyrtuar hollësitë procedurale të riadhesimit të dhunshëm në mars të vitit 2018, me kërkesë të qeverisë turke, të gjashtë shtetasve turq që banonin legalisht në Kosovë. Hetimi hasi në shumë vështirësi për ta përfunduar punën e vet. Fillimisht, disa deputetë nuk morën pjesë në mbledhjet e komisionit që të mos arrihet kuorumi. Më pas, Kuvendi vonoi zgjatjen e mandatit të komisionit dhe veproi vetëm pasi bashkësia ndërkombëtare e kritikoi për vonesën. Më 26 prill, Presidenti Thaçi u paraqit për të dëshmuar në një mbledhje të komisionit pasi i kishte refuzuar tri ftesa paraprake. Megjithatë, në vend se të dëshmonte, Thaçi vuri në dyshim ligjshmërinë e vendimit të organit për ta punësuar një të huaj si ekspert ligjor që e hartoi projekt-raportin. Thaçi gjithashtu pohoi se eksperti kishte ndarë informacione me të tjerët, përfshirë vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në maj, 52 profesorë dhe avokatë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, nga institucione si Universiteti i Harvardit, Shoqata e Avokatëve Amerikanë dhe Human Rights Watch, ia drejtuan një letër kryetarit të Komisionit Hetimor Parlamentar, Xhelal Sveçla, në të cilën i shprehnin shqetësimet e tyre ndaj “akuzave të papërgjegjshme e të pamatura” të bëra nga zyrtarët e Kosovës.

**Zbulimi financiar:** Ligji i obligon të gjithë zyrtarët e lartë publikë dhe anëtarët e familjeve të tyre që ta deklarojnë pasurinë dhe prejardhjen e pasurisë së tyre në baza vjetore. Zyrtarët e lartë duhet t'i raportojnë edhe ndryshimet në pasuri kur e fillojnë apo ndërpresin shërbimin e tyre publik. AKK-ja administron këto të dhëna, verifikon zbulimet dhe i publikon ato në ueb faqen e vet. Autoritetet mund t'i gjobisin zyrtarët e akuzuar për shkelje të vogla të kriterëve apo t'ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve publike deri në një vit. AKK-ja ua dërgoi prokurorëve të gjitha kallëzimet penale kundër personave që nuk e kishin deklaruar pasurinë.

### **Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut**

Një numër i madh i grupeve vendëse e ndërkombëtare për të drejta të njeriut në përgjithësi punuan pa u kufizuar nga qeveria, duke hetuar e publikuar gjetjet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunonte dhe nganjëherë u përgjigjej pikëpamjeve të tyre.

**Organet qeveritare për të drejta të njeriut:** Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka kompetencë për t'i hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar, dhe vepron si mekanizëm parandalues kombëtar kundër torturës. Institucioni është agjencia kryesore përgjegjëse për monitorimin e qendrave të ndalimit. Në bazë të kompetencave të dhëna nga Kuvendi, IAP-i mund të paraqesë raste *amicus curiae* në gjykatat themelore për të drejtat e njeriut. IAP-i gjithashtu mund të japë rekomandime mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore ose administrative, udhëzimeve dhe praktikave.

Në vitin 2018, qeveria formoi një ekip përgatitor për t'i hartuar termat e referencës për një Komision të ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP). Gjatë këtij viti, një ekip përgatitor u takua dhe i hartoi rregullat dhe procedurat për një KVP dhe e dorëzoi dokumentin për miratim në Kuvend. Qeveria formoi një Komision për Persona të Zhdukur, i cili, në nëntor të vitit 2018, nënshkroi me Serbinë procedurat për dorëzimin e mbetjeve të viktimave të luftës.

### **Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave**

#### **Gratë**

**Dhunimi dhe dhuna në familje:** Ligji e kriminalizon dhunimin dhe dhunën në familje ndaj të gjithë personave, përfshirë dhunimin e një të afërmi/afërmeje ose të bashkëshortit/bashkëshortes. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg. EULEX-i vuri në pah se gjykatat shpesh shqiptonin dënime më të buta se dënimi më i ulët ligjor për rastet e dhunimit dhe se organet për zbatimin e ligjit rrallë ndërmerrnin hapa për t'i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët. Përveç kësaj, këto dënime shpesh uleshin nga gjykata e apelit. Zyra e Prokurorisë për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave raportoi për një numër të madh të vetëvrasjeve në rastet e dhunës në familje. Dhuna seksuale, përfshirë dhunimin, që ndodhte brenda ose jashtë familjes ose njësisë shtëpiake, raportohet rrallë nga viktimat, shpesh për shkak të stigmës sociale ose mungesës së besimit në autoritete.

Ligji e konsideron dhunën në baza gjinore si formë të diskriminimit. Në vitin 2018, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) theksoi se vendit ende i mungon një përkufizim i dhunës në baza gjinore në procedurat penale dhe civile.

Një sektor i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ndihmoi në sigurimin e qasjes në drejtësi për viktimat e të gjitha krimeve, me fokus të veçantë në viktimat e dhunës në familje, trafikimin e personave, abuzimin e fëmijëve dhe dhunimin. Përveç kësaj, çdo zyrë e prokurorit ka një prokuror që specializohet në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje. Këta prokurorë mund të përdorin mjete për vlerësim të rrezikut për ta shmangur rrezikun e ardhshëm të abuzimit të viktimës dhe atyre u është mundësuar të rekomandojnë dënime më të ashpra për recidivistët dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës.

## KOSOVA

Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave raportoi për 946 raste të dhunës në familje në vend gjatë këtij viti. Sipas procedurave të parapara me ligj, PK-ja i heton dhe më pas ua procedon prokurorëve akuzat për rastet e dhunës në familje. Megjithatë, shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët dhe dënimet zakonisht uleshin nga gjykata e shkallës së dytë. Avokatët dhe vëzhguesit e gjykatave pohuan se prokurorët dhe gjykatësit favorizuan bashkimin e familjes ndaj mbrojtjes së viktimave, me urdhra mbrojtës që ndonjëherë e lejonin kryesin të qëndronte në shtëpinë familjare gjersa rasti ishte në procedim. Dënimet silleshin prej vërejtjeve gjyqësore deri në dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Kriminalizimi i dhunës në familje në prill u shoqërua me rritje të arrestimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për krimin.

Në nëntor të vitit 2018, Gjykata Themelore e Gjakovës e shpalli Pjetër Ndrecajn fajtor për vrasje dhe e dënoi me 24 vjet burg për vrasjen e ish-gruas së tij dhe vajzës nëntë vjeçare në gusht të vitit 2018. Ish-gruaja kishte shkuar në stacionin policor në Gjakovë pesë orë para vrasjes dhe kishte kërkuar ndihmë, por policia nuk arriti të gjente Ndrecajn para se të ndodhnin vrasjet. Në mars, Gjykata e Apelit ia shqiptoi dënimin me burgim të përjetshëm, duke vendosur se kishte rrethana rënduese shtesë që nuk ishin marrë parasysh nga Gjykata Themelore, e të cilat do t'i përmbushnin kriteret për shqiptimin e dënimit të përjetshëm. Megjithatë, në qershor, Gjykata Supreme e ktheu rastin në rigjykim, duke thënë se aktgjykimi i parë përmbante shkelje thelbësore të dispozitave të kodit të procedurës penale në lidhje me procedurën e pranimit të fajësisë, që nuk ishin shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë. Në deklaratën e tij, Ndrecaj kishte pranuar fajësinë për vrasjen e qëllimshme të gruas së tij, por pohoi se vajzën e tij e qëllloi rastësisht.

Në shtator, Gjykata Themelore në Prizren vendosi në favor të kompensimit monetar për familjen e një viktime të dhunës në familje, që ishte vrarë. Në vitin 2011, Prokuroria e Kosovës shpërfilli kërkesën e viktimës për urdhër kufizimi urgjent ndaj burrit të saj tri javë para vrasjes së saj. Vendimi për ta kompensuar familjen e saj për shkak të mosveprimit të prokurorisë shënoi herën e parë që një gjykatë në vend ka urdhëruar kompensim për një rast të tillë.

Qeveria licenoi dhe mbështeti shtatë OJQ për t'u ndihmuar fëmijëve dhe grave viktime të dhunës në familje. Dhjetë strehimore për viktimat e dhunës në familje strehuan viktime të trafikimit dhe të krimeve të tjera. Të dy OJQ-të dhe strehimoret raportuan për shqetësime se qeveria nuk i financon sa duhet dhe ua vonon pagesën për ta siguruar funksionimin e tyre. OJQ-të raportuan se financimi i qeverisë ishte joadekuat, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) konfirmoi se nganjëherë përballej me vështirësi në financimin e strehimoreve.

Në vitin 2018, qeveria themeloi një komision të pavarur për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarit të dhunës seksuale të kohës së luftës. Që nga qershori, komisioni ua kishte dhënë këtë status dhe pensionin shoqërues 395 prej 1.058 aplikantëve. Komisioni i refuzoi 152 kërkesa për shkak të dokumentacionit jo të plotë; 52 prej këtyre aplikantëve të refuzuar

## KOSOVA

paraqitën kërkesë për një shqyrtim të dytë. Kërkesat e tjera pritnin të shqyrtoheshin. PSRK-ja caktoi një prokuror për rastet e dhunës seksuale të kohës së luftës. PK-ja themeloi një njësi për rastet e krimeve të luftës, përfshirë rastet e dhunës seksuale të kohës së luftës.

**Ngacmimi seksual:** Ligji e përkufizon ngacmimin seksual në procedura civile. Ndonëse Kodi Penal e përfshin ngacmimin seksual, ai nuk përmban ndonjë standard ose përkufizim specifik. Ndryshimet e bëra në muajin prill në kodin penal i përcaktojnë dënimet me burg si dënim të shtuar për ngacmim seksual ndaj viktimave të cenueshme dhe në rastet kur procedura penale iniciohet me kërkesë të viktimës. Në rastet kur krimi kryhet me përdorim të armës, dënimi mund të sillet nga një deri në pesë vjet burg. OJQ-të raportuan se procedurat dhe rregulloret e brendshme për raportim të ngacmimit seksual e penguan zbatimin e këtyre ligjeve.

Sipas organizatave për të drejta të gruas, ngacmimi seksual në vend të punës ishte i rëndomtë në sektorin publik e privat dhe në institucione të arsimit të lartë.

**Detyrimi në kontrollin e popullsisë:** Nuk pati raporte për abortim të detyruar apo sterilizim jovullnetar.

**Diskriminimi:** Ligji parasheh status dhe të drejta të njëjta për gra dhe burra. Ligji kërkon rroga të njëjta për punën e njëjtë. Ligji përcakton që partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për të poseduar dhe trashëguar pronë, por meshkujt zakonisht e trashëgonin pronën e familjes. Në raste të rralla, të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa e veja të kthehej në familjen e saj amnore.

Relativisht pak gra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. OJQ-të pohuan që gratë u nënshtroheshin praktikave diskriminuese të punësimit.

**Përzgjedhja e fëmijës bazuar në parapëlqimin gjinor:** Raporti djem-vajza në lindje ishte 109 me 100. Sipas UNICEF-it, Qeveria nuk ndërmoi masa për ta shqyrtuar mungesën e ekuilibrit gjinor.

### Fëmijët

**Regjistrimi i lindjeve:** Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo në bazë të lindjes në vend, për fëmijët e lindur nga prindërit e komuniteteve të caktuara pakicë, shtetësia e të cilëve nuk dokumentohej. Ata që nuk ishin regjistruar kur ishin lindur ishin kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. UNICEF-i tregoi se mungesa e regjistrimit mund të ndikojë negativisht në qasjen e fëmijës në ndihma sociale, posaçërisht për fëmijët e riatdhesuar. Fëmijët e paregjistruar konsideroheshin pa shtetësi.

## KOSOVA

**Abuzimi i fëmijëve:** Kodi Penal nuk e kriminalizon në mënyrë të posaçme abuzimin e fëmijëve, por trajton elemente të ndryshme të abuzimit të fëmijëve, përfshirë sulmin seksual, dhunimin, trafikimin dhe pornografinë e fëmijëve. Dënimet sillen prej pesë deri në 20 vjet burg. Nuk dihej shkalla e abuzimit të fëmijëve në popullatën shumicë për shkak të stigmës sociale, por raportimet sugjerojnë që ajo ishte e përhapur.

Në korrik, një djalë nëntë vjeçar nga Fushë Kosova u dhunua dhe u vra. Nëna e djalit e kishte raportuar dhunimin e tij nga i dyshuari para vrasjes, por i dyshuari u lirua pas marrjes në pyetje dhe kurrë nuk u arrestua. Gjashtë muaj më vonë, fëmija u gjet i vdekur pranë shkallëve të një ndërtese në Fushë Kosovë. I dyshuari u arrestua për dhunim dhe vrasje të rëndë. Pas këtij rasti, PK-ja dhe Prokuroria filluan t'i shqyrtojnë bashkërisht të gjitha procedurat dhe veprimet në rastet e abuzimit të fëmijëve. Në nëntor, dy prokurorë të përfshirë në këtë rast u morën në pyetje për shkak të dyshimit se nuk i kishin shqyrtuar pretendimet për abuzim me kohë dhe në mënyrë efikase.

Në gusht, PK-ja në Prizren, me ndihmën e një punëtori të Caritas-it zviceran, parandaloi dhunimin e një djali 11-vjeçar rom, i cili u abuzua seksualisht nga një burrë 36-vjeçar nga Drenasi. Rasti u raportua në polici nga disa qytetarë dhe hetuesit u përgjigjën menjëherë duke kontaktuar me viktimën dhe familjen e tij. Policia bashkëpunoi ngushtë me Prokurorinë, Qendrën për Punë Sociale dhe Zyrën e Mbrojtësve të Viktimave për t'i ofruar shërbime viktimës. Një ekip i madh i hetuesve punoi për ta identifikuar dhe arrestuar të dyshuarin në këtë rast.

**Martesa e hershme dhe e detyruar:** Ligji lejon që personat të martohen në moshën 16-vjeçare. Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare për raste të martesës së hershme dhe të detyruar të fëmijëve në vend, ajo mbeti praktikë e zakonshme në disa komunitete etnike, përfshirë romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët dhe goranët. Sipas një raporti të qeverisë që përqendrohej në këto komunitete, rreth 12 për qind e fëmijëve, kryesisht vajza, martoheshin para moshës 15 vjeçare. Nivelet e larta të papunësisë në këto komunitete ishin faktorët që kontribuan në këto nivele.

**Shfrytëzimi seksual i fëmijëve:** Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personat që prodhojnë, përdorin apo përfshijnë fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë mund të dënohen prej një deri në 5 vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në 5 vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pëlqim është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale dhe dënohet prej 5 deri në 20 vjet burg.

**Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve:** Kosova nuk është palë e Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Shih *Raportin vjetor mbi*

## KOSOVA

*rrëmbimin ndërkombëtar prindëror të fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/for-providers/legal-reports-and-data/reported-cases.html>.

### **Antisemitizmi**

Sipas komunitetit hebraik të Kosovës, në vend jetonin rreth 50 hebrenj. Nuk pati raportime për akte antisemitike.

### **Trafikimi i personave**

Shih *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

### **Personat me aftësi të kufizuara**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore, dhe sigurojnë qasje të barabartë në arsim, punësim dhe shërbime të tjera shtetërore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara hasën në diskriminim.

Sipas Organizatës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, HandiKos, personat me aftësi të kufizuara nuk kishin qasje të mjaftueshme në shëndetësi, shërbime rehabilitimi, ndihmë sociale dhe pajisje ndihmëse, dhe qasja fizike në institucione publike mbeti e vështirë edhe pas zbatimit të akteve nënligjore për qasje në ndërtesa dhe mbështetjes administrative.

Ligji rregullon vendosjen e personave në objekte të kujdesit psikiatrik ose shoqëror dhe i mbron të drejtat e tyre brenda institucioneve të tilla, por nuk është zbatuar. Kosova nuk ka sistem adekuat për klasifikimin e procedurave, vendosjen dhe trajtimin e të ndaluarve me aftësi të kufizuara mendore. QKRMT-ja theksoi se objektet e shëndetit mendor ishin nën standarde dhe në përgjithësi të mbingarkuara. Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) ka një kapacitet prej 36 shtretërve, nga të cilët 12 janë për ekzaminime psikiatrike dhe 24 për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. IPFK-ja nuk ka zonë të veçantë për trajtimin e grave ose të miturve.

### **Pakicat kombëtare/raciale/etnike**

Dhuna qeveritare dhe shoqërore kundër serbëve dhe komuniteteve të tjera pakicë vazhdoi, të gjitha ishin të prekur nga diskriminimi shoqëror dhe diskriminimi në punësim.

Në shtatë muajt e parë të vitit u raportuan rreth 100 incidente që përfshinin vjedhje, grabitje, ngacmime verbale dhe dëmtim të pronës së serbëve të Kosovës dhe të Kishës Ortodokse Serbe. Organizatat ndërkombëtare theksuan që së paku katër incidente tregonin motivime të

## KOSOVA

qarta etnike, ndërsa ishte vështirë të dokumentoheshin motivimet etnike për incidente të tjera. Qeveria i dënoi incidentet dhe PK-ja filloi hetimet, që në disa raste rezultuan në arrestimin e autorëve.

Disa serbë të Kosovës raportuan për diskriminim nga serbët e tjerë për shkak të pjesëmarrjes së tyre në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Ministria e Mbrojtjes raportoi se mbi 80 serbë të Kosovës kanë dhënë dorëheqje nga FSK-ja midis vitit 2018 dhe 2019, duke cituar presionin nga autoritetet serbe dhe përfaqësuesit vendorë të komunitetit serb të Kosovës. Ata gjithashtu i nënshtroheshin ndalimit nga autoritetet serbe në vendkalimet kufitare Kosovë-Serbi. Gjatë këtij viti, FSK-ja vazhdoi t'i rekrutojë serbët e Kosovës për ta ndërtuar një forcë shumetnike e gjithëpërfshirëse.

Ndonëse qasja në drejtësi për serbët e Kosovës është përmirësuar në sajë të integritimit në vitin 2017 të sistemit gjyqësor në katër komunat veriore me shumicë serbe dhe integritimit të gjyqtarëve dhe stafit serb të Kosovës në gjykatat e tjera themelore në vend, institucionet vuanin nga mungesa e financimit dhe mbështetjes përkatëse. Përkthimi i dobët ose i vonuar në procedura para gjykatave, numri i madh i lëndëve të grumbulluara në veri, mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave, numri i kufizuar i stafit joshqiptar, dhe mospërputhja midis përkthimeve të legjisllacionit në gjuhën shqipe dhe serbe vazhduan ta pengonin ofrimin e duhur të drejtësisë për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera pakicë. Për ta trajtuar këtë problem, në maj, qeveria miratoi një koncept dokument të sponsorizuar nga komisioneri për gjuhët që përcakton krijimin e një njësie qeveritare për përkthim.

Komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian shpesh i mungonte qasja në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim, dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve dhe Institucioni i Avokatit të Popullit theksuan diskriminimin në punësim në sektorin publik pothuaj në të gjitha institucionet lokale dhe nacionale. Ndonëse ligji obligon që 10 për qind e nëpunësve në nivelin lokal dhe nacional të qeverisë të jenë anëtarë të pakicave, përfaqësimi i tyre mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi ishte i kufizuar në pozita të nivelit të ulët. Komunitetet më të vogla, si goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, ishin të nën-përfaqësuar. Nuk kishte ligje në fuqi për t'i trajtuar këto shqetësime.

Ligji kërkon kushte të barabarta për të gjithë nxënësit dhe njeh të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave deri në mbarim të shkollës së mesme. Ky ligj nuk u zbatua. Udhëheqësit e komunitetit boshnjak, kroat, goran, malazez, rom dhe turk theksuan mungesën e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera në gjuhën serbe, boshnjake e turke, herë pas here përdornin kurrikulën në gjuhën shqipe ose kurrikulën e sponsorizuar nga Serbia ose Turqia për t'i mësuar nxënësit.

Zyra e Komisionerit për gjuhët monitoronte dhe raportonte për zbatimin e legjisllacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes, si dhe gjuhëve

## KOSOVA

zyrtare në nivel lokal, përfshirë gjuhën boshnjake dhe turke. Komisioneri raportoi se administratat komunale nuk i respektonin dispozitat e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve. Si shembuj, ai përmendi mungesën e përkthimit ose përkthimin e dobët në gjuhën serbe të mbi 90 ligjeve, shenjave publike brenda shumicës së institucioneve publike dhe komunikimet me palët gjatë procedurave gjyqësore. Gjykatat rregullisht dështonin të ofronin shërbime përkatëse të përkthimit dhe interpretimit për të pandehurit dhe dëshmitarët e pakicave dhe nuk ofronin përkthim përkatës të statutit dhe dokumenteve të gjykatave siç kërkohet me ligj.

Ndryshimet e bëra në vendime administrative u lejojnë boshnjakëve dhe turqve të kenë dokumente identiteti të lëshuara në gjuhën e tyre, por përfaqësues të pakicave shpesh ankoheshin për trajtim të dobët nga shërbyesit publikë dhe zbatim të vonuar.

### **Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor**

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në punësim, kujdes shëndetësor dhe shkollim. Kur motivimi për krim është i bazuar në gjini, orientim seksual apo lidhje të perceptuar të viktimës me personat që janë objekt i armiqësisë së tillë, ligji e konsideron atë motiv si rrethanë rënduese.

Sipas OJQ-ve për të drejta të njeriut, komuniteti i lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinorëve dhe interseksualëve (LHBTI) përballej me diskriminim të hapur në punësim, strehim, përcaktim të shtetësisë, qasje në shkollim dhe kujdes shëndetësor. OJQ-të raportuan se trysnia shoqërore i bindi shumicën e personave LHBTI ta fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor dhe theksuan që policia nuk ishte e ndjeshme ndaj nevojave të komunitetit LHBTI.

Në gusht, Gjykata e Apelit miratoi një aktvendim të Gjykatës Themelore që lejonte ndërrimin e gjinisë nga gjinia femërore në atë mashkullore për një qytetar që jeton jashtë vendit. Ky vendim, i pari i këtij lloji në vend, shfuqizoi Ligjin e vitit 2011 për Gjendjen Civile duke respektuar Ligjin për Barazi Gjinore, që hyri në fuqi në vitin 2015. Ngjashëm, katër qytetarë pritnin t'i ndërronin dokumentet e tyre të identifikimit.

Sipas OJQ-ve, një grua rome, që mund të jetë transgjinore, u sulmua vazhdimisht nga banorët e Kosovës bazuar në thashetheme të rreme se ajo po kidnaponte fëmijë. PK-ja lëshoi një deklaratë për shtyp duke kërkuar ndërprerjen e sulmeve dhe duke thënë që ajo grua nuk dyshohej për kidnapim.

### **Stigma shoqërore për HIV dhe AIDS**

Nuk pati raportime të konfirmuara për diskriminim zyrtar ndaj personave me HIV/AIDS gjatë vitit.

## **Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve**

### **A. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht**

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave të pavarura, për të negociuar kolektivisht dhe për të bërë greva. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij/saj sindikale. Ligji kërkon rikthimin e punëtorëve të larguar nga puna për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë në shërbimet themelore. Ligji zbatohet njëllë për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Autoritetet nuk e zbatuan në mënyrë efektive ligjin e punës, i cili përfshin rregullore dhe udhëzime administrative që i rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, përfshirë të drejtën e lirisë së asociimit dhe negocimit kolektiv. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate dhe gjatë nuk mjaftonin. Që nga maji, Inspektorati i Punës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale shqiptoi 99 gjoba. Këto gjoba nuk mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ngatërruara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

Sipas BSPK-së, Qeveria dhe punëdhënësit privatë në përgjithësi e respektuan të drejtën për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave në sektorin publik dhe privat. Problem mbeti ndërhyrja e partive politike në organizata sindikale dhe në të drejtat e punëtorëve individualë. Sipas zyrtarëve të sindikatës, punëtorët në sektorin publik zakonisht përballëshin me keqtrajtim, përfshirë ngacmimin seksual dhe humbjen e vendit të punës, për shkak të lidhjes së tyre me parti politike. Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizimit të punëtorëve për të negociuar kolektivisht, posaçërisht në sektorin privat. BSPK-ja raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i shpërfillën ligjet e punës. BSPK-ja raportoi për vështirësi të vazhdueshme në formimin e sindikatave për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësve në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimtarisë dhe atë hotelier. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se punëdhënësit përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. Inspektorati i Punës raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim ndaj punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave gjatë vitit. Inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit.

### **B. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar**

Ligji për mbrojtjen e fëmijës, i miratuar në qershor, i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar, por puna e dhunshme e fëmijës ndodhi gjatë vitit (shih Seksionin 7.c.).

## KOSOVA

Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, nuk mjaftonin për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet për punë të dhunshme ishin të kufizuara për shkak të, sipas Inspektoratit të Punës, burimeve joadekuate. Dënimet, ndonëse ishin më të rrepta në krahasim me dënimet për krime të tjera të rënda, nuk mjaftonin për ta parandaluar punën e dhunshme. Që nga korriku, autoritetet nuk kanë identifikuar asnjë viktimitë të punës së dhunshme.

Shih gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

### **C. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punë**

Ligji i ndalon të gjitha format e këqija të punës së fëmijës. Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet. Rregulloret ndalojnë shfrytëzimin e fëmijëve në vend të punës, përfshirë punën e dhunshme apo të detyruar. Qeveria e mbështeti një autoritet kombëtar kundër trafikimit të personave, i cili i hetonte rastet e trafikimit të fëmijëve për punë.

Më 27 qershor, Kuvendi miratoi Ligjin e vet të parë për Mbrojtjen e Fëmijës, legjislacion kryesor për mbrojtjen e punës së fëmijës që i bashkon të gjitha dokumentet e tjera ligjore dhe nënligjore për këtë temë. Ligji parashikon masa dhe ndëshkime shtesë për punëdhënësit e fëmijëve që janë të mjaftueshme për t'i parandaluar shkeljet, por citimet nuk e trajtojnë këtë problem në mënyrë adekuate pasi ai nuk ndikon në rastet që ndodhin në ekonominë joformale. Ligji ua lejon autoriteteve ta largojnë një fëmijë nga shtëpia nëse vërtetohet që kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.

Agjencia për zbatimin e ligjit e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Inspektorët menjëherë njoftonin punëdhënësit kur të miturit shfrytëzoheshin ose gjendeshin në kushte të rrezikshme të punës. Që nga maji, OJQ-ja *Terres Des Hommes* raportoi rastet e 116 të miturve (105 shtetas të Kosovës dhe 11 të mitur nga Shqipëria) që punonin në kushte të rrezikshme. Prej tyre, 73 ishin fëmijë të angazhuar në lypje, 13 në punë në rrugë dhe 14 në miniera. Sipas Ministrisë së Punës, 73 persona morën këshillime në Qendrën për Punë Sociale për çështje që lidhen me punën e fëmijës.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) raportoi se fëmijët që punojnë në bujqësi hasnin në rreziqe që lidheshin me përdorimin e pajisjeve bujqësore. KOMF-i raportoi se puna e fëmijës në bujqësi vazhdoi si aktivitet tradicional. Qendrat për punë sociale, të drejtura nga qeveria, raportuan se fëmijët e angazhuar në aktivitete bujqësore nuk pengoheshin nga vijimi i mësimin. Ndonëse fëmijët rrallëherë ishin siguresit kryesorë të të

## KOSOVA

ardhurave për familjet e tyre, puna e fëmijës kontribuonte shumë në të ardhurat e disa familjeve.

Fëmijët në zonat urbane shpesh punonin në një sërë punësh joformale në ndërtimtari dhe të shitjes me pakicë, si shitja e gazetave, cigareve, ushqimit dhe kartelave të telefonit në rrugë. Disa fëmijë, posaçërisht ata nga familjet që marrin ndihmë sociale dhe nga pakicat etnike, gjithashtu angazhoheshin në punë fizike, si transportimi i mallrave dhe mbledhja e sendeve në grumbuj mbeturinash për t'i shitur.

Shih *Konkluzionet mbi format më të këqija të punës së fëmijës* të Departamentit të Punës në: <https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/findings>.

### **D. Diskriminimi në lidhje me punësimin dhe profesionin**

Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në të gjithë sektorët sa i përket seksit, gjinisë, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, fesë, përkatësisë politike dhe statusit të pakicës (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte prej sindikatave të punës dhe individëve që pohonin për diskriminim në bazë të anëtarësimit sindikal, moshës dhe gjendjes familjare. Zyrtarë të BSPK-së dhe të sindikatave theksuan se punësimi, posaçërisht në sektorin publik, shpesh varej nga statusi dhe përkatësia politike e punëtorit. Zyrtarë të sindikatës raportuan për keqtrajtime të tjera, përfshirë ngacmimin seksual, të bazuara në përkatësinë politike partiake. BSPK-ja gjithashtu raportoi raste kur punëdhënësit i diskriminuan femrat gjatë intervistave për punësim dhe i përjashtonin në mënyrë të paligjshme për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë.

Vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan për diskriminim në punësim në universitet ndaj individëve të veshur me hixhab ose simbole islame. Universitetet nganjëherë i refuzonin kandidatët mbi këtë bazë, duke justifikuar praktikën si përpjekje kundër radikalizmit.

### **E. Kushtet e pranueshme të punës**

Rroga minimale, e caktuar nga qeveria, ishte më e lartë se pragu zyrtar i varfërisë.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagesën shtesë për punën jashtë orarit dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe 12 muaj pushim pjesërisht të paguar të lehonisë. Ligji i punës i përcakton standardet e shëndetit dhe të sigurisë për vende të punës dhe qeveris me të gjitha industritë në vend.

Inspektorët e punës ishin përgjegjës për zbatimin e të gjitha standardeve të punës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me rrogat, orarin e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë. Gjjobat nuk

## KOSOVA

mjaftonin për t'i parandaluar shkeljet. Numri i inspektorëve ishte i pamjaftueshëm për t'i parandaluar shkeljet në sektorin zyrtar dhe joformal.

Sipas Inspektoratit të Punës dhe BSPK-së, ligji i punës është gjithëpërfshirës dhe dispozitat e tij për orarin e punës janë adekuate për mbrojtje të barabartë të punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. BSPK-ja raportoi për mungesën e zbatimit të ligjit nga qeveria dhe përmendi kufizimet në burime dhe kapacitete brenda Inspektoratit të Punës.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët e sektorit publik dhe privat. BSPK-ja raportoi për mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit të ligjit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, kinse sipas dëshirës së tyre, pa kontratë pune, pagesë të rregullt apo kontribute pensionale. BSPK-ja raportoi se punëdhënësit i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve. Që nga qershori, Inspektorati i Punës pranoi 1.519 ankesa zyrtare për shkelje të të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat dhe lëshoi 99 ankesa zyrtare kundër shkelësve. Organizatat për të drejtat e gruas raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual ndodhte në vend të punës, por kalonte pa u raportuar për shkak të frikës për përjashtim nga puna apo hakmarrja.

Ndonëse ligji parashikon mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe kushte të punës, institucionet private dhe publike nuk e respektonin atë çdo herë. Zyrtarët e Inspektoratit të Punës dhe të BSPK-së raportuan për vështirësi në marrjen e informatave të sakta për zbatim të ligjit, sepse punëtorët rrallë i zbulonin problemet për shkak të frikës për humbje të vendit të punës.

Asnjë ligj në veçanti nuk u lejon punëtorëve të largohen nga një situatë e rrezikshme e punës, por ligji kërkon që çdo punëdhënës t'u sigurojë të gjithë punëtorëve kushte përkatëse të punës në bazë të kërkesave të punës. Sipas Ministrisë së Punës, marrëveshjet joformale punëdhënës-punëtor mund ta trajtojnë çështjen kur dhe nëse punëtorët mund të largohen nga puna për shkak të situatave të rrezikshme të punës. Institucionet e vendit nuk e kanë përcjellë zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Sipas ekspertëve, shkeljet e standardit të rrogës, të punës jashtë orarit, të shëndetit dhe sigurisë në punë ishin njëlloj për meshkuj dhe femra, si dhe për punëtorët e huaj migrantë, posaçërisht për ata që ballafaqoheshin me kushte të rrezikshme apo eksploatuese të punës.